



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr.-030/01-1980/dt. 01/06/2026



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 53, 57 dhe 58 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Shkresës së Ministrisë së Administrimit të pushtetit Lokal Nr.0-237/2 të datës 15.05.2026, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për Shfuqizimin e Rregullores për Menaxhimin e Dokumenteve Zyrtare dhe Arkivore Nr.02-030-01-11323 e datës 30.03.2026

Neni 1

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi vendimin dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe Shkresës së Ministrisë së Administrimit të pushtetit Lokal Nr.0-237/2 të datës 15.05.2026 që në procedurën e rishqyrtimit dhe rivendosjes të shfuqizoj Rregulloren për Menaxhimin e Dokumenteve Zyrtare dhe Arkivore Nr.02-030-01-11323 e datës 30.03.2026.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal, Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë përkatëse.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

ARSYETIM

Komuna e Drenasit në harmoni me legjislacionin në fuqi i cili e rregullon këtë fushë ka filluar procedurat për hartimin dhe miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Dokumenteve Zyrtare dhe Arkivore Nr.02-030-01-11323 e datës 30.03.2026, si rrjedhojë e të cilit proces është edhe miratimi i të njëjtës. Kuvendi komunal me datë 30.03.2026 miraton rregulloren në fjalë dhe të njëjtën me datë 31.03.2026 e parashtron për shqyrtim të ligjshmërisë në MAPL.

Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal përmes aktit të saj Nr.0-237/2 të datës 15.05.2026 konstaton se akti në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si të tillë e kundërshton ecjen tutje të këtij projekt akti. Në arsyetimin e saj konstaton se Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike është kompetente për nxjerrjen e aktit nënligjorë lidhur me punën e Njesisë organizative për administrimin e dokumenteve zyrtare. Ministri i Ministrisë së Administratës Publike tani Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike me datë 27 Dhjetorë 2017 ka miratuar Udhëzimin Administrativ (MAP) nr.01/2017 për administrimin e punës në zyre, evidencat themelore dhe detyrat e punës së arkivistit që vlejné për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës në nivel Qendror dhe Lokal.

Duke marrë parasysh një situatë të tillë Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marre parasysh legjislacionin në fuqi dhe konstatimet e bëra nga Ministria gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së këtij akti të votohet ky propozim vendim.